



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JOANA SMAKAJ
ADRESA Pallatet Agimi, Rr. Bulevardi
Bajram Curri, Pallati Golloborda, Hyrje
Nr. 8
TEL: 0692039555

PROKURË E POSAÇME



Nr. repertori: 2223

Nr. koleksioni: 642

Tirane më 25/05/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë



A2021053930071072286



A2021053930071072286

PROKURË E POSAÇME

Sot, më datë 25.05.2024, para meje Notere JOANA SMAKAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Pallatet Agimi, Rr. Bulevardi Bajram Curri, Pallati Golloborda, Hyrje Nr. 8, u paraqit personalisht:

I PERFAQESUARI: Z.GALILEO EQUIZI i biri i Antonio, lindur me 17.12.1959 ne L'Aquila (AQ) dhe banues ne Silvi (TE), madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga pasaporta italiane me nr. YB0548328, i cili me kerkoi redaktimin e kesaj prokure si vijon:

Emeroj perfaqesues ligjore; **Znj.Jonida Drini**, lindur me 15.02.1987 ne Tirane, mbajttese e numrit personal I75215077E dhe **Znj.Regina Caka**, lindur me 18.01, 1984 ne Corovode, Skrapar, mbajttese e numrit personal I45118002Q, te cilat te dyja sebashku apo vec e vec, te kryejne veprime si me poshte:

- Te paraqiten prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit dhe te kryejne te gjitha veprimet qe kane te bejne me rregjistrimin e shoqerise te themeluar prej meje "NEW FINANCE CONSULTING" SH.P.K.
- Te paraqiten prane çdo zyre administrative shtetërore (Bashki, Njesi Administrative, etj), QKB, dhe te kerkoje, dorezoje, te nenshkruaje dhe te terheqe çdo lloj dokumenti si dhe te kryeje çdo lloj veprimi te nevojshem ne emrin e shoqerise "NEW FINANCE CONSULTING" SH.P.K.
- Te nxjerrin te gjithë dokumentacionin e nevojshem, pa asnje kufizim prane çdo institucioni, privat apo shtetëror qe ka lidhje me shoqerine "NEW FINANCE CONSULTING" SH.P.K.
- Perfaqesueset e mia kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet fiikisht apo edhe te gjitha llojet e aplikimit nepermjet e-Albania.
- Te me perfaqesojne kete shoqeri prane Zyres se Tatim Taksa, Sigurimet Shoqerore dhe Zyres se Punes si dhe prane çdo Institucioni tjetër Privat dhe Shtetëror.
- Përfaqësuesit, kane të drejtë, që në emrin e për llogarinë time, të paraqiten në të gjitha zyrat e Administratës publike e jo publike, shtetërore dhe private, qëndrore apo vendore e kudo ne Republikën së Shqipërisë pa kufizim per te kerkuar cdo dokument, te kryeje cdo aplikim, te nenshkruaje cdo kerkese apo dokument tjetër apo te kryeje cdo veprim te nevojshem qe ka te beje me pajisjen me Leje Qendrimi dhe Leje Pune.
- Perfaqesuesi im, ka te drejte dhe kopetence qe per tagrat e dhena ne kete prokure, te gjitha apo te pjesshme, te emeroje nje person te trete te zgjedhur prej tij.

Te gjitha veprimet e kryera nga perfaqesuesi im si me lart, apo perfaqesues te zgjedhur prej tij, i konsideroj te drejta dhe te mirqena njesoj si ti kem kryer une vete.

Kjo prokure redaktohet pa afat te paracaktuar, mund te revokohet ne çdo kohe dhe pasi i lexohet te perfaqesuarit, nenshkruhet prej tij me vullnet te lire konform ligjeve shqiptare ne fuqi.

Akti u lexua edhe ne gjuhen Italiane. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

I PERFAQESUARI
Z.GALILEO EQUIZI

Galileo Equizi
Galileo Equizi

NOTERE
JOANA GJ. SMAKAJ

PER
KANE

Date 25/05/2021

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"NEW FINANCE CONSULTING" SHPK

Neni 1

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe me Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe në përputhje me dispozitat e statutit të saj.

Neni 2

Emërtimi i Shoqërisë është "NEW FINANCE CONSULTING" SHPK.

Ortaku I vetem I shoqërisë është **Z.GALILEO EQUIZI** i biri i Antonio, lindur me 17.12.1959 ne L'Aquila (AQ) dhe banues ne Silvi (TE), madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga pasaporta italiane me nr. YB0548328,

Neni 3

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën; Rruga Ismail Qemali, Pallati 34/1, Nd.5, Hyrja 2, pasuria Nr. 2/827-N2, kodi postar 1019, Tirane.

Neni 4

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Import - Eksport, Ushtrimi i rregullt i konsulences fiskale, menaxhimi dhe perpunimi i informacionit administrativ, fiskal, taksat dhe sigurimet shoqërore ; kurse trajnimi ne ceshtjet ekonomike, teknologji e informacionit, sigurimi dhe menaxhimi financiar per bizneset ;Kompania per qellime te realizimit te objektit te veprimtarise se saj do te ndjeke aktivitetet ne vijim ; ushtrimin e funksioneve te "kujdestarit" te garantuesit , pra me te drejten dhe detyrimin per te administruar , menaxhuar ose disponuar pasurineose te drejta te vendosura nen kontrollin e saj dhe / per te cilat ajo u be pronar, sipas kushteve te garancise dhe dispozitave te veçanta te vendosura me ligj, te aplikueshme pervec aksioneve ose letrave me vlere te korporatave te kompanive te huaja " tashme " te administruara nga shoqëria ; punesimin e rojes ose kujdestarit te garancise , kudoqe eshte themeluar , ushtrimin ne perputhje me dispozitat e garancise te themeluar nga dispozitat ligjore ne fuqi dhe te cilat nuk jane garanci qe administrohen dhe menaxhohen nga kompania , te ciles ishte dhene titulli i pronesise. Import - Eksport. Ushtrimin te cdo veprimtarie te ligjshme , te lejueshme per formen e shoqërisë e cila nuk ndalohet me ligj { sipas nenit 7 te Ligjit tregtar nr. 9901, dt. 14.04.08}.

Neni 5

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pakufizuar kohe.

Neni 6

Ortak i vetem i shoqërisë është: **Z.GALILEO EQUIZI**, që zotëron 1 (nje) kuote, pra 100 (njqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë.


1



Neni 7

Administrimi i Shoqërisë do të realizohet nga administrator **Z.GALILEO EQUIZI**. Administrator e shoqërisë zgjidhet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjete mijë) Euro (dhjete mijë euro), kapital i ndarë në 1 (një) kuote, pra 100 % (njqind perqind).

Neni 9

Ky Akt Themelimi u hartua në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe në atë italiane, duke pasur të gjitha fuqi të barabartë ligjore.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQËRISE "NEW FINANCE CONSULTING" SHPK
GALILEO EQUIZI**

Galileo Equi.

PER
KANË

DATA 25.05.2021

**STATUT
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"NEW FINANCE CONSULTING" SHPK
SHPK**

**TITULLI I
EMËRTIMI I SHOQËRISË SELIA, KOHËZGJATJA**

Neni 1 - Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Është themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar një shoqëri "NEW FINANCE CONSULTING" SHPK. (këtej e tutje referuar si "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria ka vulë dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën; Rruga Ismail Qemali, Pallati 34/1, Nd.5, Hyrja 2, pasuria Nr. 2/827-N2, kodi postar 1019, Tirane.
- 2.2. Shoqëria mund të hapë apo mbyllë filiale, degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri apo jashtë saj.
- 2.3. Për sa i përket marrëdhënieve midis Shoqërisë dhe ortakëve, adresa e secilit prej ortakëve është ajo që është shënuar në regjistrin e ortakëve të Shoqërisë. Në rast se kjo adresë ndryshon, ortaku i interesuar duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Shoqërinë dhe ndryshimi duhet të pasqyrohet në regjistrin e ortakëve të Shoqërisë.

Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pakufizuar.

**TITULLI II
OBJEKTI**

Neni 4 - Objekti

- 4.1 Objekti i Shoqërisë do të përfshijë, por pa u kufizuar, aktivitetet e mëposhtme:
Import - Eksport, Ushtrimi i rregullt i konsulences fiskale , menaxhimi dhe perpunimi i informacionit administrativ, fiskal, taksat dhe sigurimet shoqerore ; kurse trajnimi ne ceshtjet ekonomike , teknologji e informacionit, sigurimi dhe menaxhimi financiar per bizneset ;Kompania per qellime te realizimit te objektit te veprimtarise se saj do te ndjeke aktivitetet ne vijim ; ushtrimin e funksioneve te " kujdestarit " te garantuesit , pra me te drejten dhe detyrimin per te administruar , menaxhuar ose disponuar pasurineose te drejttat te vendosura nen kontrollin e saj dhe / per te cilat ajo u be pronar, sipas kushteve te garancise dhe dispozitave te veçanta te vendosura me ligj, te aplikueshme pervec aksioneve ose letrave me vlere te korporatave te kompanive te huaja " tashme " te administruara nga shoqeria ; punesimin e rojes ose kujdestarit te garancise , kudoqe eshte themeluar , ushtrimin ne perputhje me dispozitat e garancise te themeluar nga dispozitat ligjore ne fuqi dhe te cilat nuk jane garanci qe administrohen dhe menaxhohen nga kompania , te ciles i eshte dhene titulli i pronesisë. Ushtrimin te cdo veprimtarie te ligjshme , te lejueshme per formen e shoqerise e cila nuk ndalohet me ligj { sipas nenit 7 te Ligjit tregtar nr. 9901, dt. 14.04.08}

A



TITULLI III

KAPITALI, KUOTAT, TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 5 - Vlera e kapitalit të regjistruar

- 5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjete mijë) Euro (dhjete mijë euro), kapital i ndarë në 1 (një) kuote, pra 100 % (njqind perqind).
- 5.2. Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuote.
- 5.3. Pronësia mbi kapitalin themeltar të Shoqërisë u perket ortakëve themelues sipas përcaktimeve të kontributeve në nenin 6 të këtij statuti.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

Emri i ortakut	Pjesëmarrja në përqindje (%) sipas kuotave
Z.GALILEO EQUIZI	1 kuote - 100 % (Nje qind)

Neni 7 - Pjesët e kapitalit themeltar

- 7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 Euro (një milion euro), kapital që është i ndarë në 1 (një) kuote.

Neni 8 - Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 8.1 Asambleja e ortakëve mund të vendosë të zmadhojë kapitalin me shumicë të kualifikuar në përputhje me nenin 12.3 të statutit.
- 8.2 Asambleja e ortakëve mund të vendosë të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë duke respektuar vlerën minimale të parashikuar nga ligji për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Nr. 9901, date 14.4. 2008, sipas procedurave të parashikuara në nenin 12.3 të statutit.

Neni 9 - Kuotat / Transferimi i Kuotave

- 9.1 Ortaku i vetem ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo teresisht kontributet e tij përfshirë dhe fondet e Kontributet në natyrë. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar, duhet të jenë të vertetuara me akt noterial dhe me shkrim.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshem në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar. Bashkeshorti dhe pasardhësit mund të behen ortakë në Shoqëri nepermjet transferimit të pjesëve të kapitalit dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj.
- 9.3 Shoqëria mund të ketë edhe kontribute të tjera në natyrë. Këtu përfshihen të gjitha sendet e paluajtshme në shërbim të shoqërisë, si dhe ato të luajtshme, të cilat kalojnë në pronësi të shoqërisë.

TITULLI IV

SEKSIONI I

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 10 - Organet e Shoqërisë

- 10.1. Organet e Shoqërisë janë:
- 1) Asambleja e ortakëve;
 - 2) Administratori/ët; dhe
 - 3) Eksperti(ët) kontabël.



SEKSIONI II
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 11 - Asambleja e ortakëve

- 11.1 Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 11.2 Çdo ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e ortakëve, të shprehë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa kuota zotëron.
- 11.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e ortakëve nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht ortak, në bazë të një prokure me shkrim. Në çdo rast, prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së ortakëve dhe është e vlefshme edhe për thirrjen e saj.
- 11.4 Një ortak nuk mund të lëshojë një prokurë për një pjesë të kuotave që ai zotëron dhe të votojë personalisht për pjesën tjetër të këtyre kuotave.
- 11.5 Asambleja e ortakëve mund të mbledhet në një vendndodhje të ndryshme nga selia e Shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.
- 11.6 Asambleja e ortakëve thirret nga Administratori/ët sa herë që të jetë e nevojshme për interesat e Shoqërisë ose në rast se kërkohet nga legjislacioni në fuqi apo ortakët, të cilët zotërojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit. Në çdo rast, Asambleja e ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit Qershor, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor të mëparshëm.
- 11.7 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së ortakëve duhet të bëhet me letër rekomande me njoftim marrjeje, të dërguar në adresën e ortakëve ose me postë elektronike në adresën elektronike të ortakëve të paktën 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.
- 11.8 Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të diskutohen dhe mbi të cilat do të merret vendim, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë, si edhe procedurat e detajuara të pjesëmarrjes dhe të votimit, informacion mbi vendin dhe mënyrat e marrjes së dokumentacionit dhe projekt vendimeve të asamblesë si edhe elementet e tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- 11.9 Asambleja e ortakëve do të quhet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin e Shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar me prokurë dhe shprehen dakord për të zhvilluar mbledhjen e asamblesë pavarësisht parregullsive në thirrjen e saj.
- 11.10 Asambleja e ortakëve mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e personave në vende të ndryshme dhe mund të mbahet edhe me anë të telekonferencës apo video konferencës, ose mjete të tjera elektronike të ngjashme me kusht që të gjithë të pranishmit të mund të identifikohen dhe t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet dhe për të marrë pjesë në to.
- 11.11 Asambleja e ortakëve drejtohet nga kryetari, i cili emërohet midis ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje. Nëse nuk kërkohet prania e një noteri publik, Asambleja e ortakëve duhet të emërojë një sekretar, i cili mund të jetë një prej ortakëve ose një person tjetër.

- 11.12 Kryetari i mbledhjes ka kompetenca të plota për të kontrolluar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblenë e ortakëve, dhe për të përcaktuar nëse asambleja është mbledhur rregullisht dhe nëse është arritur kuorumi i domosdoshëm për të marrë vendime të vlefshme. Kryetari ka gjithashtu të drejtën për të drejtuar diskutimet dhe përcaktuar metodat dhe procedurat e votimit në respektim të dispozitave përkatëse për votimin të përcaktuar në këtë statut.
- 11.13 Në rast së Shoqëria mbetet vetem me një ortak, i cili zotëron të tërë kapitalin e Shoqërisë, vendimet e marra do të regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen.

Neni 12 - Kuorumi dhe kompetencat e Asamblesë së Ortakëve

- 12.1. Në rast vendimesh të zakonshme, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kuotave me të drejtë vote. Nëse Asambleja e ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit në thirrjen e parë, asambleja mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas thirrjes së parë. Vendimet e zakonshme merren me shumicë të thjeshtë 50+1 (pesëdhjetë plus një) pra me votën pro të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë mbi 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kuotave.
- 12.2 Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të zakonshme mbi çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve.
 - d) miratimin e shpërblimeve për personat e përmendur në paragrafin (b) dhe (c);
 - e) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në proceset gjyqësore ndaj anëtarëve dhe administratorëve;
 - f) çdo çështje tjetër të përcaktuar nga ligji apo Statuti.
- 12.3 Në rast vendimesh të jashtëzakonshme, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë ortakët që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kuotave me të drejtë vote. Nëse Asambleja e ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit në thirrjen e parë, asambleja mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas thirrjes së parë. Vendimet e jashtëzakonshme merren me votën pro të të pakten 3/4 (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.
- 12.4 Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të jashtëzakonshme mbi çështjet e mëposhtme:
- a) ndryshimin apo plotësimin e Statutit të Shoqërisë;
 - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
 - c) ndryshimet në të drejtat që lidhen me kuotat ose çdo riblerje, blerje ose çdo fitim tjetër nga Shoqëria të çdo kuote apo garancive të tjera të Shoqërisë;
 - d) riorganizimin, shpërndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, likuidimin apo prishjen e Shoqërisë si edhe riorganizimin e Shoqërisë në një formë tjetër;
 - e) ndërmarrjen e çdo veprimi, i cili pritet në mënyrë të arsyeshme se do të çojë në likuidimin e Shoqërisë;
 - f) hapjen, blerjen apo shitjen e një filiali;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

SEKSIONI III
ADMINISTRATORI
Neni 13 - Administratori

- 13.1. Asambleja e ortakëve emëron 1 (një) person fizik si Administrator të Shoqërisë, i cili mund të jetë ortak ose jo dhe që do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha veprimeve të administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, në zbatim të politikave tregtare të vendosura nga Asambleja e ortakëve, sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe nga ky Statut.
- 13.2. Administratori emërohet **Z.GALILEO EQUIZI** i biri i Antonio, lindur me 17.12.1959 ne L'Aquila (AQ) dhe banues ne Silvi (TE), madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga pasaporta italiane me nr. YB0548328, për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të rizgjidhet.
- 13.2. Shoqëria merr detyrime me nënshkrimin e vetëm të Administratorit, sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe nga ky Statut.
- 13.3. Administratori e Shoqërisë duhet t'i raportojë Asamblesë së ortakëve.
- 13.4. Administratori i Shoqërisë ka të drejtën dhe detyrimin për të përfaqësuar Shoqërinë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe ligjit në fuqi.

SEKSIONI IV
EKSPERTI/ET KONTABEL I/TE AUTORIZUAR

Neni 14 - Eksperti/ët kontabël i/të autorizuar

- 14.1. Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar të emëruar nga Asambleja e ortakëve për një vit financiar.

TITULLI V
VITI FINANCIAR, FITIMET

Neni 15 - Viti financiar

- 15.1 Viti financiar fillon më 1 (një) Janar dhe përfundon me 31 (tridhjetë e një) Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Përjashtimisht viti i parë fillon në ditën e regjistrimit në QKB dhe përfundon më 31 (tridhjetë e një) Dhjetor të po atij viti.

Neni 16 - Fitimet

- 16.1 Fitimet që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, pasi të jenë zbritur të paktën 5% (pesë përqind) e kësaj vlerë si rezervë ligjore deri sa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, dhe pasi të jenë zbritur të gjitha shumat të cilat Asambleja e ortakëve ka vendosur të lërë mënjanë si fonde të destinuar për investime apo rezervë për shoqërinë, i shpërndahen ortakëve me vendim të Asamblesë së ortakëve.
- 16.2 Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të jashtëzakonshme dhe të krijojë rezerva të tjera ose specifike sipas kuorumit të përcaktuar për marrjen e vendimeve në pikën 12.3 të këtij statuti.
- 16.3 Me vendim të jashtëzakonshëm të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të vendosë të mos shpërndajë fitime duke respektuar rregullat e vendosura në pikën 12.3 të këtij Statuti.

SHOQËRIE
TITULLI VI
PRISHJA - NDARJA - BASHKIMI, LIKUIDIMI

Neni 17 - Prishja, Ndarja, Bashkimi, Blerja e Paketave Kontrolluese

- 17.1 Shoqëria mund të prishet për shkaqet e parashikuara nga ligji. Në rast prishjeje, Asambleja e ortakëve emëron një ose më shumë likuidues duke u caktuar kompetencat reciproke sipas pikës 12.2 të këtij statuti.
- 17.2 Shoqëria mund të ndahet apo bashkohet me vendim të jashtëzakonshëm të Asamblesë së ortakëve sipas pikës 12.3 të këtij statuti.
- 17.3 Shitja dhe blerja e paketave kontrolluese të kuotave të Shoqërisë nga një apo disa ortakë ekzistues të Shoqërisë, apo nga një palë e tretë do të bëhet me një vendim të jashtëzakonshëm të Asamblesë së ortakëve sipas pikës 12.3 të këtij statuti. Paketë kontrolluese të kuotave të shoqërisë do të konsiderohet blerja e çdo "Oferte kuotash", e cila e bën blerësin pas blerjes pronar të një numri kuotash të barabartë me më shumë se 51% të kuotave të Shoqërisë.

Neni 18 - Likuidimi

- 18.1 Në rast prishje Shoqëria duhet të likuidohet.
- 18.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë të cilët do të hartojnë raportin përfundimtar mbi aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë, dhe mbi procedurat dhe kohën e duhur për likuidimin sipas pikës 12.2 të këtij statuti.
- 18.3 Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e ortakëve do të vendosë mbi bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit sipas pikës 12.2 të këtij statuti.
- 18.4 Pas shlyerjes së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të mbetura, likuiduesit do tu shpërndajnë ortakëve aktivet e mbetura në përpjesëtim me kuotat që ata zotërojnë.

TITULLI VII
TE NDRYSHME

Neni 19 - Gjuha

- 19.1. Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe u perkthye ne gjuhen italiane.

Neni 20 - Dispozita Përfundimtare

- 20.1. Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, Datë 14.4.2008 i ndryshuar.

ORTAKU I VETEM THEMELUES
Z.GALILEO EQUIZI

Galileo Equizi
[Signature]

[Signature]